

EDMOND MALAJ

**MJESHTËRIT DHE ZEJTARËT SHQIPTARË
NË RAGUZË GJATË MESJETËS**

Raguza në Mesjetë ishte një vend i zhvilluar dhe aty, si zanatçi nuk mund të integroheshe lehtësisht, nëse nuk ishte i aftë. Raguza kishte nevojë për tregtarë e mjeshtër të specializuar dhe forca punëtore të afta, si p. sh. muratorë të mirë, ndërtues e bojaxhi anijesh të zotë, si dhe mjekë, farmacistë apo specialistë të fushave të tjera, të cilët ishin të mirëpritur në qytet dhe nganjëherë ftoheshin nga vetë qyteti, nëse shihej e arsyeshme.¹

Përsa i përket etnisë së tyre, Raguza nuk kishte ndonjë problem, megjithatë i rëndësishëm ishte religjioziteti i tyre, ata duhet të ishin të gjithë të krishterë katolikë, sipas një rregulli të vendosur nga Këshilli i Rogatëve (*Consilium Rogatorum*).² Megjithatë, kjo nuk do të thotë që në Raguzë, kisha kishte një pozicion të rëndësishëm në administrimin e qytetit. Në Mesjetën e Vonë, personat që i përkisnin hierarkisë kishtare ishin krejtësisht të përjashtuar nga punët shekullare dhe nga jeta politike e qytetit.³ Mbase bënin këtu përjashtim hebrenjtë, të cilët në përputhje me religjionin e tyre jetonin së bashku në një vend, ndërsa pjesa tjetër jetonin të vendosur në mënyrë individuale, të përzier me të tjerë.⁴

Në këtë komunitet profesionistësh të etnive të ndryshme, si hungarezë, kroatë dhe sllavë, gjermanë, anglezë, hebrenj, italianë, grekë etj., bënin pjesë edhe shqiptarët. Ata i hasim në Raguzë si ushtrues të profesioneve të ndryshme, që nga këpucëbërësit e muratorët deri tek mësuesit, skulptorët dhe arkitektët. Këta shqiptarë do të mundohemi t'i rendisim sipas profesioneve të tyre si në vazhdim duke ndjekur një renditje që ka të bëjë më tepër me rëndësinë e profesionit.

¹ Zdenka Janeković Römer, "Gradation of Differences: Ethnic and Religious Minorities in Medieval Dubrovnik", në *Segregation - Integration - Assimilation: Religious and Ethnic Groups in the Medieval Towns of Central and Eastern Europe*, eds. Derek Keene, Balász Nagy, Katalin Szende, London: Ashgate, 2009, f. 122.

² Po aty, f. 123.

³ Po aty, f. 125.

⁴ Po aty, f. 123.

Arkitektë dhe skulptorë

Arkitektët shqiptarë në Raguzë përmenden që në mesin e shek. XIV. Në vitin 1352 përmendet frati Domanja i Tivarit, si abat i Manastirit të Lakromës.⁵ Në kujtimet e at Erasmo Balneos OFM, të sjella nga at Zef Pllumi, përmendet frati Miho Brajko nga Tivari, i cili kishte bërë punime të shkëlqyera në Kuvendin Françeskan “*Male Braçe*” të Raguzës në vitin 1360.⁶ Mihoja duket se ka qenë një mjeshtër i madh skulptor, të cilit “*nuk i gjindej shoqi në të tanë Europën*”⁷. Këtë mjeshtër e përmend edhe studiuesi Jahja Drançolli, i cili thotë se ishte “një skulptor zulmëmadh i shek. XIV, autor i klaustrit të Kuvendit Françeskan në Raguzë si dhe i disa veprave të tjera të njohura të kohës”⁸. Bie në sy mbiemri i tij “Brajko” që në fakt nuk duket si një mbiemër familjar, por më tepër ngjan me një titull në gjuhën sllave dhe don të thotë “vëlla”.




Fig. 1: Epitafi i Mihos (Mikelit) nga Tivari në Kuvendin Françeskan. Burimi: T. G. Jackson, *Dalmatia: the Quarnero and Istria*. Vol. II, f. 373.

Jahja Drançolli e jep emrin e tij si *Mihi (Mikel)* Tivarasi, dhe sipas tij, Miho Tivarasi ishte edhe një ndër arkitektët dhe skulptorët që u angazhuan edhe në ndërtimin e kishës së manastirit të Deçanit si dhe të Katedrales së Novo Bërdës, sepse këto kisha, sipas J. Drançollit, kanë

⁵ Irmgard Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern während des Mittelalters. Randbemerkungen zur Problematik der balkanologischen Forschung”, në *Beiträge zur Südosteuropa-Forschung*, Anlässlich des I. Internationalen Balkanologenkongresses in Sofia 26.VIII-1.IX.1966, botuar nga Arbeitskreis Südosteuropa-Forschung bei der Deutschen Forschungsgemeinschaft, München: Trofenik, 1966, f. 369.

⁶ Zef Pllumi, *Frati i Pashallarëve Bushatli të Shkodrës (At Erasmo Balneo) (1756-1788)*. *Kronikë e gojzhanë*, Shkodër: Botime Françeskane, 2017, f. 79.

⁷ *Po aty*.

⁸ Jahja Drançolli, “Monumentet e kultit katolik gjatë Mesjetës në Kosovë”, në *Krishterimi ndër shqiptarë*, Simpozium ndërkombëtar, Tiranë, 16-19 nëntor 1999, Konferenca Ipeshkvnore e Shqipërisë, Shkodër: Phoenix, 2000, f. 149.

motive identike me ato të Kuvendit Françeskan të lartpërmendur të Raguzës.⁹ Për origjinën e tij shqiptare flet edhe studiuesi Thomas Graham Jackson në veprën e tij “*Dalmatia...*”, i cili e përmend atë si “*Mjeshtër Miha, një shqiptar nga Tivari*” (*Master Mycha, an Albanian of Antivari*).¹⁰ Në atë manastir gjendet edhe Epitafi i tij, të cilin po e paraqesim më poshtë sipas, T. G. Jacksonit.

Në lidhje me arkitektët e shohim me vend që të përmendim këtu edhe një tjetër arkitekt shqiptar, ky është Andrea Aleksi nga Durrësi (*Andrea di Alessio ose Andrea Alexi di Durrazzo*), punën e të cilit, edhe pse jo në Raguzë, prapëseprapë e gjejmë të dokumentuar në disa vende të Dalmacisë si p. sh. në Trogir, Arbe dhe Split.¹¹ Në Arbe, punimet e tij gjenden në kishën e Shën Gjon Pagëzorit (S. Giovanni Battista), e cila më vonë u shkatërrua dhe mbetjet e saj u përdorën për të ndërtuar kishën e Shën Justinës.¹²

Dhe pikërisht në pjesë të ndryshme të dyshemesë së kësaj kisha u gjetën në vitin 1859 nga historiani austriak i artit, Rudolf von Eitelberger von Edelberg (1817-1885) edhe fragmentet e një mbishkrimi që përmendin emrin e Andrea Aleksit.¹³ Fragmentet ishin të shpërndara, por




Fig. 2: Fragmentet e mbishkrimit të gjetura të kishës së Shën Gjon Pagëzorit me emrin e Andrea Alexit nga Durrësi, viti 1454, në: Th. G. Jackson, *Dalmatia* III., f. 233

⁹ Po aty.

¹⁰ Thomas Graham Jackson, *Dalmatia: the Quarnero and Istria*, with Cettigne in Montenegro and the Island of Grado, volume II, Oxford: At the Clarendon Press 1887, f. 372.

¹¹ Thomas Graham Jackson, *Dalmatia: the Quarnero and Istria*, with Cettigne in Montenegro and the Island of Grado, volume I, Oxford: At the Clarendon Press 1887, f. 225.

¹² Thomas Graham Jackson, *Dalmatia: the Quarnero and Istria*, with Cettigne in Montenegro and the Island of Grado, volume III, Oxford: At the Clarendon Press 1887, f. 233.

¹³ Rudolf von Eitelberger von Edelberg, *Gesammelte kunsthistorische Schriften*, Band IV: Die mittelalterlichen Kunstdenkmale Dalmatiens in Arbe, Zara, Nona, Sebenico, Traù, Spalato und Ragusa, Von Rudolf von Eitelberger von Edelberg. Mit 115 Illustrationen im Text und 26 Tafeln. Nach den Zeichnungen des Architekten Winfried Zimmermann, Wien: Wilhelm Braumüller, 1884, f. 80.

kur u bashkuan doli teksti i mëposhtëm të cilin po e japim të pasqyruar në figurë. Aty shënohet emri i mjeshtrit Andrea Aleksi nga Durrësi që e bëri atë vepër në vitin 1454 (...*Magister.Andreas.Alexi de Dvrachio. fecit.hoc.opvs.MCCCCLIII*).¹⁴



Fig. 3: Mbishkrimi në pagëzimoren e Trogirit me emrin e Andrea Alexit nga Durrësi, viti 1467, në: Th. G. Jackson,

Në Trogir punimet e Andrea Aleksit nga Durrësi (*Andrea Alexi di Durrazzo*) gjenden në kapelën e Shën Gjon Orsinit, të cilat i bëri në bashkëpunim me arkitektin Nicoló Fiorentino, me të cilin ai punoi edhe në qytetet e sipërpërmendura Arbe dhe Split.¹⁵ Punët e tij janë të shpërndara nëpër vende të ndryshme të Dalmacisë. Kontrata për punimet në kapelën e sipërpërmendur u lidh më 4 janar 1468, kundrejt një pagese prej 3300 dukatësh dhe këto punime zgjatën rreth 6 vjet.¹⁶ Kapela është në formën drejtkëndore, me një arkitekturë të pasur të periudhës së Rilindjes. Ndër punimet e shumta që ndodhen brenda kësaj kapele, është edhe një skulpturë, e cila qe bërë nga vetë Andrea Aeksi i Durrësit, në bashkëpunim me Nicolo-n e sipërpërmendur. Kjo skulpturë është e Shën Gjon Ungjilltarit dhe është bërë në vitin 1482.¹⁷

Andrea Aleksi nga Durrësi bëri në këtë qytet edhe një pagëzimore, të cilën mesa duket e përfundoi në vitin 1467.¹⁸ Në anën e brendshme të portës së kësaj pagëzimoreje ekziston edhe një mbishkrim ku përmendet emri i tij, të cilën po e pasqyrojmë edhe në këtë artikull. Sipër përmendet emri i papës, më poshtë është emri pretorit të kësaj kishe dhe në fund jepet edhe emri *Andrea Aleks Durrsaku, skulptor 1467 (Andreas Alexius Durrha-chinus Opifec MCCCCLXVII)*.¹⁹ Disa vite më vonë, në vitin 1472, në Split, Andrea Aleksi nga Durrësi riparoi së bashku me Nicoló Fiorentino-n këmbanaren e katedrales.²⁰

¹⁴ Po aty; shih edhe: Th. G. Jackson, *Dalmatia* III., f. 233.

¹⁵ Th. G. Jackson, *Dalmatia* II., f. 128.

¹⁶ Po aty.

¹⁷ Po aty, f. 129.

¹⁸ Po aty, f. 133.

¹⁹ Po aty.

²⁰ Th. G. Jackson, *Dalmatia* II., f. 53.

Siç duket mjeshtërit shqiptarë të arkitekturës dhe të ndërtimtarisë, duke përfshirë këtu edhe gurgdhendësit për të cilët do të flasim edhe më poshtë nuk ishin të paktë. Jo më kot studiuesi me origjinë arbanase (shqiptare)²¹ nga Kotorri, Giuseppe Gelcich në veprën e tij “*Zeta dhe Dinastia e Balshajve*” shkruan se “*i zgjuar nga natyra dhe i pajisur me një shije të jashtëzakonshme, shqiptari i kishte stolitur qytetet e veta me monumente artistike shumë të çmuara.*”²² Madje, Gelcich në këtë linjë mendimi shkon edhe më tej, kur thotë që shqiptarët kishin ndikuar pa diskutim në rritjen dhe në zhvillimin e qyteteve të Dalmacisë nëpërmjet emigracionit, që në kohën e Balshajve kishte arritur një gjallërim të veçantë.²³ Thëniet e tij dëshmojnë më së miri qoftë në rastet e arkitektëve që përmendëm më sipër, qoftë edhe nga pjesa në vazhdim ku bëhet fjalë për gurgdhendësit.




Fig. 4: Kapitelet e mjeshtërit Miho (Mikel) nga Tivari në Kuvendin Françeskan. Burimi: T. G. Jackson, *Dalmatia: the Quarnero and Istria*. Vol. II, f. 371-72.

²¹ Sipas dr. Bedri Muhadrit, studiuesi Giuseppe Gelcich (sllav. *Josip Jelčić*) ishte arbëresh nga Zara e Kroacisë. Shih: Bedri Muhadri, *Prizreni në Mesjetë shek. XI-XV*, Prishtinë: Brezi, 2013, f. 10.

²² Giuseppe Gelcich, *Zeta dhe Dinastia e Balshajve*, përktheu nga origjinali Laura Leka, Tiranë: Shtëpia botuese “55”, 2009, f. 366.

²³ *Po aty*.

Gurgdhendësit

Nëpër dokumentet mesjetare gurgdhendësit përmenden më së shumti me terminologjinë “*petrarius/ petraro*” dhe “*taiapiera*”. Përsa u përket gurgdhendësve bien në sy sidomos mjeshtër dhe punëtorë që vijnë nga Tivari. Qyteti i Tivarit është një qytet malor që shtrihet në këmbë të malit të Rumijes jo shumë larg bregut të Adriatikut. E kemi fjalën këtu për Tivarin e vjetër, i cili ndodhet disa kilometra larg portit të Tivarit. Sot, qyteti është krejtësisht i rrënuar dhe pikërisht tek këto rrënoja shihet qartë që aty ka mbizotëruar punimi në gur. Aty ka rrënoja kishash me kapitete e dekoracione të skalitura shtëpish të mëdha dhe ndërtesash të ndryshme të gjitha në gurë.

Nëpër fragmentet e ndryshme që gjenden të shpërndara në të gjithë arealin gjejmë ornamente lulësh dhe lloje të ndryshme dekorimesh të gdhendura me finesë e me mjeshtëri të madhe. Kjo dëshmon qartë traditën e pasur që pati qyteti në punimin e gurit gjatë periudhave të ndryshme duke përfshirë këtu edhe mesjetën. Kjo traditë na vjen e dëshmuar edhe nëpërmjet dokumenteve të ndryshme, disa prej tyre po i citojmë edhe më poshtë duke pasqyruar veprimtarinë e mjeshtërve të Tivarit.

Jo vetëm në Tivar, por edhe në qytete të tjera si Ulqin, Shkodër, Krugë etj., etj., punimi i gurit ka pasur mjeshtërit e vet. Më poshtë po përmendim disa nga këta mjeshtër dhe veprimtarinë e tyre në Raguzë. Më së shumti aty bien në sy dy familje Brajko (Brajković) dhe Boroeviq (Boroević)²⁴, anëtarët e së cilës do t'i përmendim më poshtë duke respektuar rendin kronologjik.

Në vitin 1432 përmendet edhe gurgdhendësi Ratko Braikoviq (Ratchus Braichouich petrarius), me rastin e përpilimit të dokumentit të prikës për martesën ndërmjet tij dhe Slavusës të bijës së një personi të quajtur Gjon Shqiptari (*Slauussa f. qu. Gion albanese*), e cila më parë kishte qenë e martuar me Juan Soriq, por që pastaj kishte mbetur e ve (*relicta des Juanis Sorich*).²⁵

²⁴ Riccardo Belcari, “Da Antivari a Ragusa. Litotecnica dell’Edilizia medievale in Dalmazia”, në *VII Congresso nazionale di archeologia medievale*, (Palazzo Turrisi, Lecce, 9-12 settembre 2015), Volume 1, a cura di Paul Arthur, Marco Leo Ipmeriale, Firenze: All’Insegna del Giglio, 2015, f. 129.

²⁵ I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern ...”, f. 372.

Në vitin 1333 përmendet mjeshtri Dragos, gurpunues nga Tivari (*Magister Dragos petrer de Antibarō*), i cili duhej të përgatiste për raguzanin Iuno de Volkasso gurë të kuq të gdhundur. Kjo punë duhej të bëhej në Tivar dhe materiali duhet të dërgohej në Raguzë me anë të detit.²⁶ Ndër të tjerë përmenden edhe mjeshtri Dragush (*maestro Dragos petrarius de Antibarō*) dhe gurgdhendësi Obrati nga Tivari (*Obrat petrer de Antibarō*), që ishte banues në Raguzë dhe punonte me gurë në Curzola. Të dy këta përmenden në vitin 1334,²⁷ Obrati mesa duket kishte edhe një vëlla tjetër që merrej me këtë punë. Ky ishte Milku që përmendet në vitin 1339 (*Milcus frater de Obrat de Antibarō petrar*).²⁸

Në manastirin e Shën Benediktit të Kotorrit përmendet për punën e tij edhe një tjetër mjeshtër nga Tivari, *Radossio Ivanni de Antibarō*.²⁹ Në vitin 1335 kemi të dokumentuar edhe një Rado, gurgdhendës nga Tivari (*Radoe petrarius de Antibarō*),³⁰ i cili i përkiste familjes së lartpërmendur Boroëviq (Boroëvić), dhe po kësaj i përkiste edhe gurgdhendësi Mare nga Tivari (*Maroe petraro de Antibarō*) që përmendet në vitin 1345.³¹ Më 14 korrik të vitit 1341 përmendet edhe gurgdhendësi Micoe që ishte bashkëshorti i Mirnës, e cila kishte në posedimin e vet një tavernë (*Micoe petraro de Antibarō, maritus Mirne tabernarie*).³²

Një tjetër gurgdhendës, Boksa (*Bo(c)ssa de Antibarō*) që ishte aktiv në Raguzë³³ përmendet në vitin 1347 me dy kolegët e tij, Grube dhe Pale, që ishin vëllezër dhe të bijtë e një farë Borke³⁴ (*Grube et Pale, fratres et filii qu. Borche*). Këta përmenden disa herë nëpër dokumente, sidomos të vitit 1347. Boksa, Grube dhe Pale kishin krijuar një ortakëri (*companiam*) siç parashikohej në atë kohë me ligj, për të prodhuar gurë të skalitur në

²⁶ "1333, 1.iunii. Ragusii. "Magister Dragos petrer de Antibarō" obligat se Iunio do Volcasso, "de incidendo sibi iuxta Antibarum lapides rubeas (!) circa centum" conducendas, "deorsum ad marinam" (CASSA).. "Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia, Collegerunt et digesserunt Dr. Ludovigus de Thallóczy, Dr. Constantinus Jireček ed Dr. Emlilianus de Sufflay, Volumen I (Annos 344-1343 tabelamque geographicam continens) Vindobonae MXMXVIII. Typis Adophi Holzhausen, nr. 768 (Cituar si: AAlb I, nr.)

²⁷ R. Belcari, "Da Antivari a Ragusa ...", f. 129.

²⁸ I. Mahnken, "Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern ...", f. 372.

²⁹ R. Belcari, "Da Antivari a Ragusa ...", f. 129.

³⁰ AAlb. I, nr. 768, ref. 1.

³¹ R. Belcari, "Da Antivari a Ragusa ...", f. 129.

³² AAlb. I, nr. 768, ref. 1.

³³ R. Belcari, "Da Antivari a Ragusa ...", f. 129.

³⁴ I. Mahnken, "Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern...", f. 372.

ishullin e Korculës. Këta gurë ata mund t'i dërgonin në Raguzë dhe në vende të tjera dhe të gjitha fitimet që do të nxirrnin nga këto gurë duhet t'i ndanin në tri pjesë të barabarta.³⁵

Ata kishin një marrëveshje edhe për veglat e punës. Duhet të mbanin vetëm ato që kishin.³⁶ Kjo çështje e veglave mbase kishte të bënte me problemin e konkurrencës. Që të ishte e mundur të bëhej punë, pa bërë konkurrencë të pandershme, me siguri duhej që të përcaktoheshin edhe llojet dhe sasia e veglave për një punë të caktuar. Jemi të mendimit se kështu mund të interpretohet pasazhi i mësipërm në dokument. Disa nga veglat e punës që ata përdornin ishin “*carpetta*” dhe “*slavina*” që mendojmë se ishin lloje të ndryshme daltash, dhe *cassa* që mund të ketë qenë ndonjë lloj arke. Më tej përmendet edhe çekiçi (*martellum*).

Këto vegla janë të shënuara me rastin e një premtimi që Grube, gurgdhendësi i bën Boksës, se do të dërgonte këto tri vegla (*unam carpettam, unam slavinam, unam cassam, unum martellum*) në Raguzë.³⁷ Këta tre gurskalitës përmenden sërish në një dokument tjetër të 9 dhjetorit 1347 në lidhje me një marrëveshje për prodhim gurësh të skalitur të përmasave 8, 10, 11 dhe 12 pëllëmbësh, të cilët duhej të dërgoheshin nga Korcula në Raguzë.³⁸

³⁵ “1347, 20. augusti. Ragusii. Bogsa, petrarius Antibarensis cum sociis lapides incidet in Curzola. Grube et Pale, fratres et fillii condam Borche petrarii et Bossa petrarius de Antibaro faciunt manifestum, quod faciunt simul companiam hoc modo videlicet, quod omnes tres simul debent ire Curcolam ad incidendum et faeiendum lapides et conducendum illos Ragusium uel ad alias partes sicut eis placuerit et laborare et vendere dictos lapides prout eis videbitur pro melliori dicte companie; et totum illud, quod de dictis lapidibus litcrabitur, tercia pars esse debet dicti Bosse et due partes esse debent dictorum fratrum et similliter de omnibus expensis et dampno, quod eueniret dicte companie, quod deus aduertat.” *Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia*. Collegerunt et digesserunt Dr. Ludovigus de Thallóczy, Dr. Constantinus Jireček ed Dr. Emilianus de Sufflay, Volumen II (Annos 1344-1406 continens Vindobonae MCMXVIII. Typis Adophi Holzhausen, nr. 34. (Cituar si: AAlb. II, nr.)

³⁶ “*Et est pactum inter eos, quod dictus Bossa non tenetur ponere feramenta allia quam illa, que ad presens habet et similliter dicti fratres. Renuptiantes ambe partes etc. (CASSATA de voluntate dicte Grube et Bosse).*” AAlb. II, nr. 34.

³⁷ “*Die 10. Decembris, Grube petrarius promittit “Bosse petrario de Antibaro in hoc presenti viagio de Curcola aportare et assignare in Ragusio” unam carpettam, unam slavinam, unam cassam, unum martellum*” AAlb. II, nr. 34.

³⁸ “1347, 9. decembris, Ragusii, “*Bocssa de Antibaro petrarius*” et socii supranominati “*lapides magnos excisos alla petra delle saline de Curcola per numerum XI, unum de*

Boksa arriti të pasurohej e të integrohej shumë mirë në shtetin raguzan. Këtë e shohim tek bijtë e tij, të cilët u bënë tregtarë të pasur nëpërmjet tregtisë me Bosnjën. Bie në sy kryesisht Gjergji (*Georgius*), i cili së bashku me djalin e tij Nikollën (*Nicola*) u bënë protovestiarë të mbretit të Bosnjës. Gjergji qe protovestiar gjatë viteve 1369-1388,³⁹ kurse i biri i tij Nikolla, gjatë viteve 1404-1405.⁴⁰ Në vitin 1379, përmendet një gurgdhendës tjetër, por kësaj radhe nga Spasi. Ky gurgdhendës ishte Andrea (*Andreas petrarius de Spaço*), të cilit i përmendet emri në lidhje me zbatimin e testamentit të tij.⁴¹

Kovaçët, farkëtarët e shpatave dhe prodhuesit e armëve të tjera

Edhe farkëtarët janë të përmendur nëpër dokumentet raguzane. Farkëtarët ishin ata zejtarë që merreshin me prodhimin e sendeve të ndryshme duke filluar nga veglat bujqësore e deri tek armët. Këtë profesion e gjejmë me termin “*fabrus*”. Tek ky profesion një grup të veçantë përbënin farkëtarët e shpatave, të cilët i gjejmë me termin “*spatarius*”, “*spadarius*”⁴², apo “*spatharius*”⁴³. Nuk duhet të ngatërrohemi këtu me “*spatharius*”, të cilët ishin ata persona që merreshin me ruajtjen e shpatave të një fisniku a kalorësi, apo përdorues të shpatës, sepse edhe këta emërtohen me të njëjtin term.⁴⁴

Ndër këta farkëtarë shpatash mund të përmendim Marin shpatarin (*Marinus spatarius*) nga Tivari, i cili përmendet në testamentin e tij të

palmis XII, unum de X et residuum de palmis VIII” inter se dividunt, ut “veniendo dicti lapides Ragusium tercia pars sit dicti Bosse”. AAlb. II, nr. 34.

³⁹ “*Die XIII Augusti. In consilio rogatorum ball, XXVIII. Prima pars est de mittendo unum nostrum nobilem pro ambassiatore ad dominum regem Bossine. Capt. per XXI.*” *Monumenta Ragusina. Liber Reformationum Tomus IV.* A. 1364-1396. Zagabriae: Sumptibus Scientiarum et Artium 1896, f. 156. (=Monumenta spectantia historiam Slavorum meridionalium. Volumen XXIII); (Cituar shkurt si: Liber Reformationum IV, (1364-1396, f.), shih edhe: AAlb. II, nr. 34.

⁴⁰ “*Filius huius Bogšae Georgius postea (1369-1388) protovestiarius erat regis Bosnae, similiter etiam eius filius Nicola (1402-1407)*”. AAlb. II, nr. 34.

⁴¹ I. Mahnken, “*Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern...*”, f. 372.

⁴² AAlb. II, nr. 140.

⁴³ *Monumenta Ragusina. Liber Reformationum Tomus II.* A. 1347-1352. 1356-1360. *Additamentum a. 1301-1305, 1318.1325-1336.* Zagabriae: Sumptibus Scientiarum et Artium 1882, f. 109.

⁴⁴ Po aty.

vitit 1330, ku shënohen një shtëpi bashkë me truall në Tivar, si dhe shtëpia e motrës po në Tivar. Mesa duket viti 1330 është edhe data e vdekjes së Marinit. Në një testament tjetër të vitit 1338 përmendet edhe Pakussa, e veja e Marinit, e cila martohet përsëri me Marinin, të birin e Pashk Sibranit (*Marinos f. Pasque de Çibrano*) dhe nëpër dokumente ajo përmendet si Pakussa e një farë Marini shpatar nga Tivari (*Paccussa qu. Marini spatarii de Antibaro*).⁴⁵

Po nga Tivari ishte edhe farkëtari Brato (*Bratoe spadarius de Antibaro*), i cili ishte banues në Raguzë, por që gjatë një udhëtimi në korrik të vitit 1359 zihet rob së bashku me njerëzit e tij nga piratët e Budvës.⁴⁶ Nga farkëtarët që prodhonin shpata kemi edhe një nga Vlora, i cili përmendet në vitin 1365. Ky është shpatëpunuesi Dhimitër (*Dymitriys spadarius de Valona*), i cili zotohet se do t'i çonte një personi me emrin Dymos nga Vlora një objekt argjendi (*ladiçam nam argenti*).⁴⁷

Ndër farkëtarët e tjerë mund të përmendim farkëtarin Kraislavin, të birin e Millatkos nga Spiçi (*Crayslaus faber, fiolo de Millatcho de Spiç*),⁴⁸ një lokalitet në afërsi të Rotecit (sot në Mal të Zi), jo shumë larg nga Tivari. Gjithsesi Spiçi në mesjetë gjeografikisht bënte pjesë në territorin e *Albania Medievalis* (Arbëria Mesjetare).⁴⁹ Në lidhje me Kraislavin, studiuësja I. Mahnken vë re lidhjet e ngushta që ai ka me shqiptarë sidomos nga zona e Shkodrës. Kraislavi vdiq nga murtaja që ra në vitin 1391 dhe në testamentin e tij, krahas pjesëtarëve të familjes shënohen edhe emrat e dy shkodranëve.

I pari ishte *dom Andrea i Shkodrës* që ishte kapelan i kishës së Shën

⁴⁵ I. Mahnken, "Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern...", f. 375.

⁴⁶ Libri Reformationum II (1347-1352, 1356-1360), f. 275; shih edhe: AAlb. II, nr. 140.

⁴⁷ AAlb. II, nr. 140. Fjalën *Ladiça* e cila është mesa duket me origjinë sllave, nuk mundëm ta përkthenim, kështu që ia dhamë kuptimin si "objekt argjendi".

⁴⁸ I. Mahnken, "Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern...", f. 375.

⁴⁹ Në lidhje me Arbërinë Mesjetare dhe kufijtë e saj shih: Milan von Šufflay, "Das mittelalterliche Albanien", në *Illyrisch-Albanische Forschungen*. Unter Mitwirkung von Professor Dr. Konstantin Jireček, Professor Dr. Milan von Šufflay, Sektionsschef Theodor Ippen, Professor E. C. Sedlmayr, Archivar Dr. Josef Ivanič, Weiland Emmerich von Karácson, K. Ung. Sektionsrat Béla Péch und Karl Thopia. Zusammengestellt von Dr. Ludwig von Thallóczy. I. Band. Mit einer Landkarte. München/Leipzig: Duncker und Humblot 1916, f. 282-287; si dhe: Milan von Šufflay, "Die Grenzen Albaniens im Mittelalter", në *Illyrisch-Albanische Forschungen I...*, f. 288-283. Për kufijtë e Arbërisë Mesjetare është gjithashtu me rëndësi edhe harta e botuar nga Konstandin Jireček, Milan fon Shufflay dhe Ludvig fon Tallocci në vëllimin me dokumente AAlb I, pa nr. faqeje (293) në fund të vëllimit.

Dominos (*dom Andrea de Scutaro capelano de S. Domino*) dhe i vëllazërisë së flaxhelantëve me të njëjtin emër (*fratiglia S. Domini*). Dom Andrea i Shkodrës kishte qenë ati shpirtëror i Krasilavit dhe në testamentin e tij ishte shënuar si një ndër garantuesit e testamentit. Garantuesi tjetër ishte një person me të njëjtin emër, zoti *Andrea i Shkodrës*, me profesionin kopshtar (*don Andrea de Scutaro ortolano de le punçele*).⁵⁰ Megjithëse I. Mahnken nuk jep një saktësim në lidhje me etninë e Kraislavit, ka shumë mundësi që ai të ketë qenë shqiptar, ose mund të ketë pasur lidhje të forta familjare me shqiptarët.

Në Raguzë jetonte edhe mjeshtri Leksi, farkëtari nga Drishti (*mgr. Lexio fabro de Drivasto*), emri i të cilit mesa duket shënohet edhe në një shpërndarje testamentare të vitit 1370,⁵¹ ku ndër të tjera shënohet edhe shuma prej 10 dukatësh, që mjeshtri Leksi i kishte dhënë priftit Lazër, i cili ishte gjithashtu nga Drishti.⁵²

Një tjetër farkëtar që përmendet në Raguzë është edhe Milan Gjinoviq (Milan Gjini) (*Milan Chinouich*). Emri i Milan Gjinoviqit dhe i gruas së tij Nikoletës (*Nicoletta*) gjendet nëpër dokumente testamentare dhe noteriale ndërmjet viteve 1374 dhe 1390.⁵³

Nga farkëtarët që bënin shpata, të cilët vinin nga Ulqini përmendet Niksa (ose Nika) Malmanoviç ose Milmanoviç, i cili bëhet qytetar i Raguzës në vitin 1383.⁵⁴ Ai ishte i martuar me Bielisen, një grua raguzane, e cila përmendet në vitin 1399, por në atë kohë mesa duket Nika nuk jetonte më. Në këtë dokument të vitit 1399, Bielisa cakton si administratore të sajën Katushën nga Raguza, e cila ishte e shoqja e të ndjerit Adrusa Petrulini po nga qyteti i Ulqinit.⁵⁵ Edhe pse dokumenti nuk ka të bëjë tërësisht me farkëtarë, e sollëm atë për të nxjerrë në pah

⁵⁰ I. Mahnken, "Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern...", f. 375.

⁵¹ Po aty.

⁵² "Anno 1370, 29. novembris, Ragusii "Dominicus Lievor de Drivasto" recipit a "presbytero Laçaro de Drivasto" (cf. infra doc. 1400, 8. martii) ducatos 10, quos presbyter Laçarus recepit a magistro Lexio fabro de Drivasto "causa emendi sibi unam incudem" AAlb. II, nr. 257, ref. 2.

⁵³ I. Mahnken, "Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern...", f. 375.

⁵⁴ "Anno 1383, 4. maii „Nixa Malmanovich (!) de Dulcinio factus fuit civis Ragusii". AAlb. II, nr. 622, ref. 1.

⁵⁵ "1399, 21. aprilis. Ragusii. "Bielliça filia Goyslavi Xuch de Ragusio, olim uxor Nichoe Milrmanovich spatarii de Dulcinio" "Katussam de Ragusio, olim uxorem quondam Andrusse Petrulini de Dulcinio" proeuratricem suâm instituit." AAlb. II, nr. 622.

sadopak edhe marrëdhëniet që kishin familjet shqiptaro-raguzane me njëra-tjetrën, si në këtë rast ku bëhet fjalë për gra të veja raguzane që kishin burrat nga qyteti i Ulqinit.

Në vitin 1386, përmendet edhe një farkëtar nga Shkodra. Ky ishte mjeshtri Nikolla (*magister Nicholaus faber de Scutaro*), i cili ishte dëshmitar në një lidhje kontrate pune ndërmjet Lazër Kaligjergj Ransit nga Shën Shirqi i Arbërisë (*Laçarus Caligergji Ransi de S. Sergio de Arbania*) dhe Johanit nga Ravena që ishte noter në Raguzë, tek i cili Lazri zotohej se do të punonte për dhjetë vjet.⁵⁶ Ndër dëshmitarët e tjerë të kësaj marrëveshjeje përmendet edhe dom Marku famullitar i Novo Bërdës (*Novomonte*) në Kosovë dhe dom Martini nga Drishti.⁵⁷

Nëpër dokumente përmendet edhe farkëtari Nikolla me gruan e tij, Barbarën nga Shkodra (*Barbara de Scutaro uxor qm Nicole fabri*).⁵⁸ Bile në lidhje me këtë familje përmendet edhe i vëllai i Barbarës dhe djali i saj, të cilët ishin priftërinj. I vëllai i Barbarës ishte dom Dhimitri nga Shkodra, që përmendet si prift sllav në Brenno, kurse i biri, i cili quhej po ashtu Dhimitër dhe përmendet si *dom Dymitrio* ose *dom Demetrius*, mesa duket, vdiq në vitin 1391 për shkak të murtajës.⁵⁹

Ndër farkëtarët e shpatave apo të ashtuquajturit shpatarë përmendet edhe Gjink shpatari (*Ghincus spatarius*), i cili kishte një pozicion të lartë, sepse që prej vitit 1382 ishte *gastalt* i vëllazërisë së lartpërmendur të Shën Dominos (*fraternitas s. Domini*).⁶⁰ Ai kishte bërë edhe një dokument dhuntie (*carta dotalis*) në vitin 1386, ku janë të shënuar edhe anëtarë të tjerë të familjes si dhe emri i tij i plotë si Gjink Jovanoviqi (*Ghincus Juanouich*).⁶¹ Nga ky dokument, mësojmë se, gruaja e tij ishte Stanika, e bija e një personi me emrin Prelubit. Aty përmendet edhe një thjeshtër, i quajtur Stiepkko si dhe një nip Goysa e një mbesë Visinja (*Visigna*). Edhe Gjinku vdiq në vitin e murtajës 1391.

Ndër mjeshtrit që prodhonin armë përmenden edhe specialistë që

⁵⁶ "1386, 27. martii. Ragusii. "Laçarus Caligergji Ransi de S. Sergio de Arbania" operam suam ser Johanni de Ravenna, notario communis Ragusii, per 10 annos locat; pleçius: "magister Nicholaus faber de Scutaro". Teste "dompnus Marchus plebanus Novimontis et dompnus Martinus de Drivastio". AAlb. II, nr. 393.

⁵⁷ AAlb. II, nr. 393.

⁵⁸ I. Mahnken, "Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern...", f. 375.

⁵⁹ Po aty, f. 368.

⁶⁰ Po aty, f. 375.

⁶¹ Po aty.

nuk kishin të bënin vetëm me prodhimin e shpatave, por edhe të armëve të tjera. Këtu mund të përmendim për vitin 1402 “mjeshterin Ivan nga Durrësi, nëpunës i bashkisë së Raguzës” (*majstor Ivan iz Drača, službenik dubrovačke općine*), i cili prodhonte për qytetin e Raguzës balista, ndërsa në vitin 1442 përmendet si mjeshtër armësh edhe Mark Progoni, i cili ishte nga krahina e Lumbardës në Korcula (*lumbardar Marko Progonović*)⁶². Këtë mjeshtër, I. Manken e klasifikon si shqiptar.

Me mbiemrin *Progonović* (Progoni) dhe që ishte i lidhur ngushtë me Korculën, sepse vinte nga ai vend, por që ushtronte zanatin e argjendarit në qytetin e Raguzës, përmendet edhe Ivan Progonović, i cili vlerësohej si mjeshtër i madh e i famshëm dhe prej punës së të cilit ka mbetur vetëm një kryq i artë.⁶³ Duke u nisur nga mbiemri dhe se ishte nga i njëjti vend me Marko Progonoviçin e lartpërmendur, mund të supozojmë se edhe ky mund të ketë qenë me origjinë shqiptare.

Lundërtarët

Profesionin e lundërtarit e gjejmë me fjalët *nauklerus*. *Nauklerus* ishte përgjegjës për manovrimin e anijeve me vela.⁶⁴ Këtë profesion e gjejmë të dokumentuar sidomos në shek. XIV. Gjatë vitit 1366 përmenden lundrime të bëra për në trojet e bregut të Bunës, si për shembull për tek manastiri i Shën Kollit të Bunës që gjendet në grykë të Bunës (*ad buccam fluminis Oldrini*) dhe në tregun e manastirit të Shën Shirqit po në Bunë.⁶⁵ Një “*nauklerus*” që ka udhëtuar për në këto vende përmendet në një dokument të datës 26 prill 1367. Ky ishte Nikolla Skuarkarvela nga Durrësi (*nauklerius Nicolaus Squarcavela de Duracio*), i cili zotohet se do të sillte material drusor në manastirin e Shën Kollit në

⁶² Po aty.

⁶³ “[...] srebrni križ glasovitog dubrovačkog zlatara Ivana Progonovića, također po naruđbi iz Korčule učinjen, jedino sačuvano djelo toga majstora.” Vinko Foretić, “Korčula u domaćim i međunarodnim relacijama”, në *Prilozi povijesti umjetnosti u Dalmaciji*, vol. 22, nr. 1/ 1980, (Split: Ministarstva kulture Republike Hrvatske), f. 115.

⁶⁴ *Horizons marins, itinéraires spirituels (Ve-XVIIIe siècles)*, volume II: Marins, navires et affaores Etudes réunies par Henri Dubois, Jean Claude Hocquet, André Vauchez, Publications de la Sorbonne: 1987, f. 125.

⁶⁵ “1366, 7. martii, Ragusii, navigationes memorantur “ad buccam fluminis Oldrini”, “ad forum S. Sergii”. AAlb. II, nr. 219, ref. 4.

breg të Bunës (*Sancto Nicola de Oldrino*).⁶⁶

Më 25 qershor të vitit 1367 kemi edhe një dokument tjetër ku përmendet një vendim i marrë në Këshillin e Vogël të Raguzës, për të urdhëruar pronarë anijesh që të shkojnë në brigjet e lumit Buna për të sjellë materiale prej druri, pa përmendur cilët ishin këta pronarë anijesh.⁶⁷

Vozaxhinjtë

Profesionin e vozaxhiut e gjejmë nëpër dokumente me terma të ndryshme si *botarius* apo edhe *cuparius*.⁶⁸ Profesionin e vozaxhiut ishte shumë i rëndësishëm, jo vetëm në prodhimin e vozave dhe të enëve të ndryshme prej druri, por edhe si specialist në transportin e fuçive (*botarius*) apo të shekave të ngarkuara me produkte të ndryshme.⁶⁹ Ndër këto produkte që mbarteshin me sheka dhe fuçi mund të përmendim verën, vajin etj.

Këta vozaxhinj, përveç punës së tyre që kishte lidhje me prodhimin e vozave dhe të objekteve të tjera prej druri, shpeshherë ishin të detyruar që të shoqëronin edhe vozat e ngarkuara me produkte si vera, vaji apo drithi, për të garantuar kështu transportin e këtyre lëndëve. Në një lundrim jo të qetë ngarkesa edhe mund të dëmtohej, kështu që ishte e nevojshme mbikëqyrja e këtyra vozave të mbushura plot nga një specialist që i përkiste zanatit.⁷⁰ Kështu, në mënyrë të vazhdueshme kemi të dokumentuar vozaxhinjë që përmenden për transportin e këtyre mallrave nëpër vende të ndryshme.

Përveç kësaj, ata shoqëronin vetë edhe produkte druri të ndryshme. Si shembull, mund të përmendim vozaxhinjtë, Juan Muskoviçin nga Zeta (*Juan Muscouich de Çenta botarius*) dhe Pjetër Miloseviçin nga Tivari (*Petre Miloseuich de Antibaroi botarius*), të dokumentuar më 26 tetor 1366, të cilët ishin banorë të Raguzës dhe ishin zotuar që të transportonin

⁶⁶ "1367, 26. aprilis, "naucclerius Nicolaus Squarcavela de Duracio" obligat se "adducere lignum a Sancto Nicola de Oldrino". AAlb. II, nr. 219, ref. 4.

⁶⁷ "De precipiendo patronis barchosiorum, quod vadant Oldrinum pro palis pontis preparandi." Liber Reformationum IV, (1364-1396), f. 95; shih edhe: AAlb. II, nr. 219.

⁶⁸ AAlb. II, nr. 434.

⁶⁹ *Horizons marins, itinéraires spirituels (Ve-XVIIIe siècles)*, Volume II: Marins, navires et affaires Etudes réunies par Henri Dubois, Jean Claude Hocquet, André Vauchez, Publications de la Sorbonne: 1987, f. 125.

⁷⁰ *Po aty*.

materiale druri, shtylla dhe trarë nëpër vende të ndryshme përgjatë lumit Buna, e cila na jepet me emrin *Oldrino* (Drin).⁷¹ Pjetër Miloseviqi nga Tivari përmendet edhe një vit më vonë, në shtator të vitit 1367.⁷²

Materialet prej druri që ata transportonin, mund të ishin edhe të tyre, kur këta bënin marrëveshje të kryenin punë të ndryshme. Jemi të mendimit se një rast i ngjashëm ishte edhe ai i Jovan Brankoviçit nga Perasti (*Juan Brankouich de Parast*) dhe Dragoshit vozaxhiut (*Dragosio botario*), të cilët në maj të vitit 1366 shkojnë për të punuar së bashku në viset e bregut të Bunës.⁷³

Marangozët

Në Raguzë kishte edhe marangozë shqiptarë. Këta i gjejmë të specifikuar nëpër dokumente me termin *marangonus*. Në librat e arkivit të Raguzës përmenden zejtarë nga qyteti i Balecit, që ishin punues të drurit (*marangoni*).⁷⁴ Ndër ta gjejmë Palë marangozin nga Baleci (*Paulus marangonus de Balezio*), i cili përmendet në dy dokumente, më 2 maj 1395 dhe më 1 prill të vitit 1398.⁷⁵ Në dokumentin e datës 2 maj 1395 thuhet se tek Pali nga Baleci shërbente edhe Jurglio Braikoviçi nga Korusi i Arbërisë (*Jurglio Braychovich de Choruçi Albanie*). Jemi të mendimit që edhe Jurglio i lartpërmendur i përkiste këtij profesioni.⁷⁶ Me toponimin *Kurus* (*Choruçi Albanie*), mbase duhet të kuptohet këtu fshati malor *Garuc*, i cili ndodhet në zonën ndërmjet Balecit dhe Drishtit.

Dy marangozë të tjerë janë edhe Gogoe Dobroslaviq dhe Bogdan Dranksinoviçi mesa duket që të dy nga qyteti i Ulqinit, të cilët zotohen për të bërë gati ngarkesa me lëndë druri në Bunë dhe në ishullin Gjiran në

⁷¹ “1366, 26. octobris. Ragusii.: “*Juan Muscouich de Çenta botarius habitator Ragusii et Petre Miloseuich de Antibaroi botarius*” obligant se dare procuratoribus Sanctae Mariae de Ragusio “*ad ripam fluminis de Oldrino*” lignamina, pallos, trabes etc.” AAlb. II, nr. 219.

⁷² “1367, 23. septemhris, “*Petrus Milosevich botarius de Antibaroi, habitator Ragusii*” memoratur”. AAlb. II, nr. 219, ref. 3.

⁷³ “23. maii, Ragusii, “*Juan Brankouich de Parast*” (! Perasto) ibit “*laborare Oldrinum*” cum *Dragosio botario*.” AAlb. II, nr. 219, ref. 4.

⁷⁴ Konstantin Jireček, “Skutari und sein Gebiet im Mittelalter”, në *Illyrisch-Albanische Forschungen*, I, f. 101.

⁷⁵ “*Paulus marangonus de Balezio*” Ragusii memoratur 1398, 1. Aprilis”. AAlb. II, nr. 434, ref. 2.

⁷⁶ “1395, 2. maii “*Jurglio Braychovich de Choruçi Albanie*” serviet “*Paulo de Ballegio marangono*”. AAlb. II, nr. 434.

afërsi të Ulqinit (*ad Drinum et ad Agiranam*). Lokacioni *ad Drinum* (në Drin), siç e kemi përmendur edhe herë të tjera ka të bëjë me Bunën, e cila në mesjetë quhej Drin, e jo me lumin Drin të vërtetë. Lënda e drurit ishte për të ndërtuar anije dhe ishte bërë me porosinë e fisnikëve raguzanë Simon de Bona dhe Paulo de Gondula.⁷⁷

Në dokumentin që cituam më sipër, të datës 25 qershor të vitit 1367 në një vendim të Këshillit të Vogël të Raguzës urdhërohen pronarë anijesh, që të shkojnë në brigjet e lumit Buna e të sjellin dërrasa dhe shtylla druri të përgatitura.⁷⁸ Por në këtë rast nuk përmenden karpentierët që merreshin me këtë punë.

Argjendarët

Përsa i përket këtij zanati Raguzë ishte një shkollë e madhe, ku vinin e mësonin teknikat e këtij profesioni. Përveç lidhjes së saj me brendësinë, Dubrovniku si një qytet bregdetar ishte në kontakt të vazhdueshëm me qytetet bregdetare të Dalmacisë, me Zetën dhe me bregdetin shqiptar, dhe prej këtyre vendeve prindërit i dërgonin fëmijët në Raguzë për të mësuar këtë mjeshtëri artizanale.⁷⁹ Ndër mësuesit e shumtë përmendet edhe një shqiptar për të cilin do të flasim më poshtë. Ky ishte Llesh argjendari (*Les aurese*)⁸⁰, i cili përmendet edhe me emrin Aleks Kalogjorgjeviq arpunuesi (*Alexius (Alessius) Caloiurgieuich aurifex*)⁸¹.

Lleshi kishte edhe çirakët apo nxënësit e vet shqiptarë. Ndër këta çirakë përmendet në vitin 1379, Volkotë Pjetri i Arbërisë (*Volchotta Petrovich de Albania*), i cili shërben pranë Lleshit për nëntë vjet me radhë.⁸² Më tej, Lleshi del i dokumentuar që në vitin 1367 si epitrop (garantues) i Rusës, gruas së raguzanit të pasur Bogauë de Tholoe. Gruaja e Lleshit ishte Rada, e bija e Bratoslavit (*Radio. f. Bratoslavi* – për nga emri mbase raguzane) e cila në martesë solli një prikë (pajë) prej 1000

⁷⁷ AAlb. II, nr. 719.

⁷⁸ “*De precipiendo patronis barchosiorum, quod vadant Oldrinum pro palis pontis preparandi.*” Liber Reformationum IV, (1364-1396), f. 95; shih edhe: AAlb. II, nr. 219.

⁷⁹ Cvito Fisković, “Dubrovački zlatari od XII do XVII stoljeća”, në *Starohrvatska prosvjeta*, vol. III, Nr. 1, Split: Muzej hrvatskih arheoloških spomenika, 1949, f. 164.

⁸⁰ I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern...”, f. 373, ref. 79.

⁸¹ “*Aleksija Kalojurđevića*”. C. Fisković, “Dubrovački zlatari ...”, f. 165.

⁸² “*1379, 24. februarii “Volchotta Petrovich de Albania” serviet apud Alexium Calogiurgevich aurificem annos 9*”. AAlb. II, nr. 346.

dukatësh, gjë që tregon edhe origjinën e saj nga një familje e pasur.⁸³

Ndër njerëzit e afërm të Lleshit përmenden edhe nipa e mbesa, si p. sh. mbesa Stane, për të cilën u lëshuan dy dokumente prike (*carta dotalis*) njëra në vitin 1382 në lidhje me Voksin Bogdanoviq (*Vochçin Bogdanouich*) dhe një tjetër në vitin 1386 në lidhje me Ponos Miloseviq (*Ponos Miloseuich*).⁸⁴ Këto dy dokumente prike mbase duhet të kuptohen si për dy lidhje martesore njëra pas tjetrës të Stanes në fjalë, ndoshta edhe për shkak të vdekjes së bashkëshortit të parë. Po ashtu përmendet edhe Bogoslavi, një nip i Lleshit në vitin 1390, po atë vit që Lleshi vdes.⁸⁵

Ndër mjeshtërit e tjerë argjendarë në Raguzë, tek i cili shkonin të mësonin zanatin shqiptarët, përmendet edhe raguzani *Nikola de Brundusio*. Në vitin 1394, tek Nikola de Brundusio dërgohet për të mësuar profesionin e argjendarit Marini, djali i madh dymbëdhjetëvjeçar i Gjergj Mamolit nga Tivari.⁸⁶ Marini duhej të qëndronte tek ky mjeshtër afërsisht 8 vjet. Pak a shumë ky dokument tregon edhe kohëzgjatjen që nevojitej për mësimin e këtij profesioni, derisa çiraku bëhej vetë mjeshtër. Në rastin e Marinit të lartpërmendur kohëzgjatja ishte 12 vjet, një interval kohor relativisht i gjatë.

Më tej, po japim disa nga argjendarët dhe arpunuesit me origjinë shqiptare, që i kemi gjetur gjatë hulumtimit tonë. Duhet të thuhet këtu se shumë arpunues të Republikës së Raguzës e kishin origjinën nga Arbëria, por shpeshherë këta nuk mund të identifikohen si të tillë nga që nuk kanë as patronime shqiptare dhe as nuk u shkruhet vendi i origjinës. Bien në sy kryesisht argjendarët nga Tivari, por edhe nga Ulqini kishte shumë prej tyre.⁸⁷

Në shek. XIV, përmendet Pali nga Drishti, i cili në fakt është i dokumentuar në Split, ku i vihej rëndësi qoftë performancës, qoftë pastërtisë së metaleve të arit dhe argjendit sidomos në monedha, dhe kjo rregullore ishte e përcaktuar edhe në Statutet e Splitit.⁸⁸

Në vitet 1389 dhe 1391 përmendet një arpunues i quajtur Gjergji

⁸³ I. Mahnken, "Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern...", f. 373, ref. 79.

⁸⁴ Po aty.

⁸⁵ Po aty.

⁸⁶ "1394, 10. novembris "Georgius Mamollo de Antibarò" filium suum Marinum maiorem, 12 annorum dedit magistro Nicolao de Brundusio aurifici Ragusino "ad artem aurificum", ad annos 8." AAlb. II, nr. 434.

⁸⁷ C. Fisković, "Dubrovački zlatari ...", f. 148.

⁸⁸ Po aty, f. 147.

argjendar, i biri i Palit nga Shën Shirqi në afërsi Shkodrës (*Georgius aurifex f. q. Pauli de Sancto Sergii* ose *Georgios Paulovich*). Ai ishte i martuar mesa duket me një vendase, e quajtur Dobrula e bija e Juroe Ibrojiçiq (*Dobrula f. Juroe Ybroycich*).⁸⁹ Mbi aktivitetin e tij nuk kemi hëpërhë të dhëna të tjera.

Nga viti 1401 deri në vitin 1403 në Raguzë dokumentohet mjeshtri arpunues, Milçe Stani nga Ulqini (*magistro Milçe Quondam Stani de Dulcinio aurifici*), i cili më vonë duket se është larguar nga ky vend për t'u vendosur në Kotorr, ku del i dokumentuar në vitin 1405 si qytetar i këtij qyteti (*Milçe aurifex de Dulcineo, cives Cathari*).⁹⁰ Emri i këtij arpunuesi na del edhe në një dokument tjetër raguzan i cili është një vendim i Këshillit të Vogël të Raguzës, i datës 12 qershor 1389, që përbën rëndësi të veçantë, sepse na vërteton në mënyrë indirekte ekzistencën e monedhave të tipit folar për Ulqin. Në dokumentin që po citojmë thuhet se “*Gjithashtu në këtë Këshill u mor parasysh që edhe për Ulqinin mund të bëhen folarë që të jenë të vetat (të qytetit - E.M.), që të shpenzohen në qytetin e tij nga vetë Milçe arpunuesi*”.⁹¹ Pra, Milçe i lartpërmendur, mund të ketë qenë i pari person që ka pasur në përdorim folarë të tillë. Duhet të kujtojmë këtu që monedhat e Ulqinit kishin në një rën anë pamjen e Shën Marisë që ishte shenjtorë mbrojtëse e qytetit.⁹² Këto monedha të Ulqinit duhet të jenë shtypur pikërisht në Raguzë në punishten e prodhimit të monedhave që ndodhej brenda saj dhe jo brenda qytetit shqiptar, siç bën të ditur Theodor Ippen.⁹³

Po ashtu edhe arpunuesi, Dapko Bratanoviq (*Dapko Bratanović*)⁹⁴ duhet të ketë qenë shqiptar. Për origjinën e tij shqiptare studiuesja

⁸⁹ I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern...”, f. 373, ref. 79.

⁹⁰ AAlb II, nr. 749, ref. 1

⁹¹ “*Item in eodem consilio fuit attentum, quod idem (!) de Dulcinio possint facere fieri cuneos folarorum suorum expendendorum in sua civitate a Milzo aurifice*”. AAlb II, nr. 399.

⁹² Ćiro Truhelka, “Verzeichniss der bosnischen, serbischen und bulgarischen Münzen des Landesmuseums in Sarajevo”, në *Wissenschaftliche Mitteilungen aus Bosnien und der Herzegowina*, Herausgegeben von Bosnisch-Hercegovinischen Landesmuseum in Sarajevo, Redigiert von Dr. Moriz Hoernes. Vierter Band. Wien: In Commission bei Carl Gerold's Sohn, 1896, f. 305.

⁹³ Theodor Ippen, “Über Münzen Albaniens”, në *Numismatische Zeitschrift*. Band XXXIII./ Jahrgang 1901. Wien: Numismatische Gesellschaft, 1902, f. 193.

⁹⁴ C. Fisković, “Dubrovački zlatari ...”, f. 242.

gjermane, I. Mahnken i referohet një dokumenti raguzan të vitit 1389.⁹⁵ Për këtë identitet me rëndësi është edhe testamenti i tij, ku përmenden gruaja Gjuka (*Giucha*) e bija Marusha (*Marussa*) dhe argjendarët Dhimitri (*Dimiter orese*), Pripko Borgoviq (*Pripcho Borchouich*) Gjurko Gjinoviq (Gjini) (*Gurcho Ghinouich*), i biri i Gjini Shqiptarit (*Chin arbanese*), i cili ishte edhe njëri prej krijuesve të familjeve të Shoqërisë së Shën Antonit (*Antunini*).⁹⁶

Përsa i përket shek. XV mund të përmendim këtu Nizhe Radakoviçin (Niže Radaković). Ai ishte nga Ulqini dhe jetonte në Zarë, por pastaj prej andej erdhi në Raguzë. Me sa duket qysh në gjysmën e parë të shek. XV bëri gdhendje bakri, duke qenë kështu i pari i kësaj dege, edhe para fiorentinasit Thomas Finiguerra, i cili konsiderohet themeluesi i degës në Raguzë.⁹⁷

Ndër shqiptarët që punonin si të punësuar tek argjendarët shqiptarë në Raguzë mund të përmendim si të tillë Tomasin, të birin e Pavel Dominkoviqit nga Pulti që ishte i punësuar në vitin 1402 tek mjeshtri arpunues Milçe Stani nga Ulqini që e përmendëm më sipër.⁹⁸

Në vitin 1471 përmendet edhe Llesh Dimitri argjendari (*Les Dimitrovivh aurifex*), i cili duke u nisur nga emri Llesh jemi të mendimit se mund të ketë qenë shqiptar.⁹⁹ Arpunuesit, përveç se me zanatin e tyre, merreshin intensivisht edhe me tregti dhe si rrjedhojë shumë prej emrave të tyre janë të shënuar në regjistrat e Shoqërisë së Shën Antonit.¹⁰⁰ Përsa i përket objekteve të argjendarisë që vinin nga Arbëria mund të përmendim vathët e mëdhenj që vinin nga Vlora, për të cilat nuk bëhet e njohur se nga çfarë materiali ishin (*I par de cercelli grandi de Avalona, 1387*).¹⁰¹ Këto vathë prodhoheshin në Vlorë dhe kishin gjetur treg në Raguzë, por

⁹⁵ “*Dapko Bratanović* (mit Verweis auf Div. Not. X, 59, 1389) ist offensichtlich ebenfalls albanischer Herkunft gewesen” I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern...”, f. 373, ref. 79.

⁹⁶ Po aty, f. 373-74, ref. 79.

⁹⁷ C. Fisković, “Dubrovački zlatari ...”, f. 148.

⁹⁸ “*Thomas filius Pauel Dominovich de Pilloto partium Albanie llocat se magistro Milçe Quondam Stani de Dulcinio aurifici.*” AAlb II, nr. 749.

⁹⁹ I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern...”, f. 374, ref. 79.

¹⁰⁰ Po aty, f. 374.

¹⁰¹ Verena Han, “La culture matérielle des Balkans au Moyen Age à travers la documentation des Archives de Dubrovnik”, në: *Balkanica. Annuaire de l'Institute des Etudes Balkaniques III*, Academie Serbe des Sciences et Arts (Institute des Etudes Balkaniques), Beograd: 1972, f. 180.

nuk përjashtohet mundësia që me kalimin e kohës mund të jenë prodhuar edhe në Raguzë nga mjeshtërit shqiptarë.

Këpucarët

Në Raguzë kemi këpucarë shqiptarë, të cilët vinin nga krahina të ndryshme të trojeve arbërore. Në vitin 1341, përmendet Obrat këpucari nga Tivari (*Obrat caligarius de Antibaro*) dhe Karavidë këpucari (*Carauida caligarius*) ose Gjuko Karavida (*Giucho Carauida*), i cili përmendet me të birin, Stiepkko i Gjuko Karavidës (*Stiepkcho de Giucho Carauida*)¹⁰², dhe që të dy këta, babë e bir janë shënuar në regjistrin e shoqërisë së Shën Antonit (*Antunini*).¹⁰³

Po ashtu nga Tivari ishte edhe këpucari Stanku (*Stanchus chalegarius de Antibaro*), i cili përmendet në dokumentet raguzane më datë 2 mars 1342¹⁰⁴ dhe më 5 shkurt 1349.¹⁰⁵ Rreth 30 vite më vonë në vitin 1372 tek Stanku vjen e punësohet edhe një tivaras tjetër. Ky ishte Lazri, i biri i Gjergj Kalimanit nga Tivari (*Laçarus filius Georgii Chalimanovich de Antibaro*).¹⁰⁶ Si në këtë rast, ashtu siç do ta shohim edhe në raste të tjera, mjeshtërit preferonin t'i kishin çirakët ose të punësuarit nga vendi i tyre.

Në një dokument të datës 19 mars 1344, përmendet Marku nga Tivari (*Marcus de Antibaro*), i cili vihet në dispozicion me punën e tij në Raguzë tek këpucari Bratano, dhe në këmbim duhej t'i sigurohej ushqimi dhe veshmbathja.¹⁰⁷ Edhe pse në dokument nuk del e qartë, jemi të mendimit që Marku i sipërpërmendur duhet të ketë qenë njohës i këtij profesioni ose mbase çirak i Bratanos së lartpërmendur.

Më 1350 përmendet mjeshtri “Nikollë këpucari, i biri i Vitanit nga Shkodra” (*magister Nicola chalegarius filius Vitani de Schutari*)¹⁰⁸ pra, siç e thotë edhe vetë emri, ishte me origjinë nga Shkodra dhe atë vit më

¹⁰² I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern...”, f. 374.

¹⁰³ Po aty.

¹⁰⁴ Liber Reformationum II, (1347-1352...), f. 61.

¹⁰⁵ AAlb. II, nr. 346, ref. 1.

¹⁰⁶ “1372, 2. decembris, “Lacarus filius Georgii Chalimanovich de Antibaro” serviet apud Stagnum calegarium.” AAlb. II, nr. 346.

¹⁰⁷ “1344, 19. martii, Ragusii, “Marcus de Antibaro ponit se et opera sua cum Bratano caligario” pro victu et calceamentis.” AAlb. II, nr. 60.

¹⁰⁸ I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern...”, f. 374.

datë 2 maj 1350 i jepet nënshtetësia e Raguzës.¹⁰⁹ Së bashku me të i jepet qytetaria e Raguzës edhe një shqiptari tjetër, të ashtuquajturit Gjergji, të birit të Sime Kocanit nga Ulqini.¹¹⁰ Mesa duket nga Shkodra kemi edhe një këpucar tjetër, ky ishte Uitiesi (Utiessen), për të cilin në një shpërndarje testamentare të vitit 1384, thuhet se e kishte zakon që të shkonte e të qëndronte në Shkodër (*qui solebat ire et stare in Scutari*).¹¹¹

Po ashtu nga Shkodra është edhe një këpucar tjetër, Pjetri (*Petre de Scutari*) i cili është i dokumentuar më 1 dhjetor 1350. Pjetri deklaroi se për një vit vihet në dispozicion me punën e tij dhe me mjeshtërinë e tij në profesionin e këpucarit, se bashku me Dobren, i cili ishte gjithashtu këpucar. Rroga e tij do të ishte 8 perperë dhe do t'i sigurohej edhe ushqimi,¹¹² sipas zakonisht që paguheshin këpucarët e Serbisë, si dhe do t'i jepej edhe një tunikë (braga) dhe një këmishë (interula)¹¹³ Në vitin 1365, së bashku me shqiptarë të tjerë që regjistroheshin si të punësuar në Raguzë, përmendet edhe këpucari Gjoni nga Tivari (*Johannes de Antibarō calegarius pleçius*)¹¹⁴, por dokumenti ku ky përmendet nuk jep të dhëna të tjera rreth aktivitetit të tij.

Tek rrethi i këtyre zanatçinjve bënte pjesë edhe Jonk Këpucari (*Jonchus Calegarius*) dhe më 1369 përmendet e shoqja e tij e vdekur Milio, e cila kishte lënë një testament me zbatimin e të cilit po merrej prifti Dhimitri nga Drishti (*presb. Demetrius de Drivasto*).¹¹⁵ Me origjinë shqiptare ishte edhe Dapko këpucari nga Tivari (*Dapcho caligaro de Antibarō*) që përmendet edhe me emrin Dabes Markoviq këpucari (*1370 Dabeç Marchouich caligar*). Më 15 dhjetor të vitit 1370, Dapko Këpucari përmendet edhe në një marrëveshje që bën me marangozin Bogoe

¹⁰⁹ “Magister Nicola chalegarius, filius Vitani de Schutari, in dicto minori consilio factus fuit ciuis Ragusii; qui iuravit modo supradicto.” Liber Reformationum II, (1347-1352...), f. 102.

¹¹⁰ Liber Reformationum II, (1347-1352...), f. 102; shih edhe: “1350, 2. mai. Ragusii. “Georgius filius Syme Chozani de Dolcigno” in minori consilio civis Ragusinus fit. Similiter „magister Nicola chalegarius filius Vitani de Schutari”. AAlb. II, nr. 74.

¹¹¹ I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern...”, f. 374.

¹¹² “1350, 1. decembris. Ragusii. Scutarensis operam sitam locat. Petre de Scutari facit manifestum quod locat se et opera sua in arte chalegiorum ad standum cum Dobre chalegario hinc ad ·1· annum pro yperperis VIII et victu, · 1· pari chalegarum de Raxa, ·1· braga et ·1· interula (aliis omissis).” AAlb. II, nr. 80.

¹¹³ Fjalët *braga* dhe *interula* i përkthyer me “tunikë” dhe “këmishë” – E.M.

¹¹⁴ AAlb. II, nr. 208.

¹¹⁵ I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern...”, f. 374.

Galvanus, për t'i bërë mbulesën e pullazit një shtëpie dhe në shtrimin e dy dysHEMEVE.¹¹⁶

Nga familja e këpucarit Dapko përmendet edhe i vëllai i tij, Gone, e ëma Nisa, dhe e shoqja e Dapko Velios (*Dapcho Velios*). Të gjithë këta persona përmenden në testamentin e Dapko këpucarit, të bërë më 1395.¹¹⁷

Edhe nga Durrësi kemi të dokumentuar një këpucar. Ky ishte i ashtuquajtur i mjeshtri Dominik këpucari (*Dominicus de Durachio cerdo*), i cili vdiq rreth vitit 1400.¹¹⁸

Në vitin 1381 përmendet martesë e durrsakes Jakusa me këpucarin Pribislav Dragoslaviqin (*calegarius Pribislavus Dragoslavich*). Jakusa ishte e bija e Aleksit nga Durrësi (*Jachussa f. qu. Alexii de Duracio*) dhe e veja e Isarit po nga Durrësi (*Issarus de Durachio*). Në vitin 1395 ajo lëshon dokumentin e saj të trashëgimisë.¹¹⁹

Shqiptarët i gjejmë të dokumentuar edhe si nxënës nëpër këpucarë. Si shembull mund të përmend këtu Nikollë Lazrin (Lazareviqin) nga Shën Shirqi i Bunës (*Nicola Lazarovich de Sancto Sergio Oldrini*), i cili në nëntor të vitit 1391 zotohet para të atit të tij, Lazrit se do të qëndrojë për shtatë vjet pranë një këpucari në Raguzë me qëllim që të mësojë zanatin e këpucarit.¹²⁰

Përsa i përket martesave të tjera në vitin 1393, përmendet edhe Lessin këpucari, emrin e të cilit e gjejmë të shënuar në një dokument dhuntie (*carta dotalis*) të vitit 1393 për martesën e tij me Gliubenën të bijën e Ponos (*Gliubena f. Ponos*).¹²¹ Në vitin 1397 në testamentin e dom Dhimitrit nga Drishti, ndër persona të tjerë përmendet edhe këpucari Nikolla, i cili e kishte dom Dhimitrin at shpirtëror dhe rrëfimi (*Nichola chaliger mio fiol de penitencia*).¹²² Nikollë këpucari ishte një nga garantuesit e testamentit të dom Dhimitrit. Në testament nuk përmendet

¹¹⁶ "1370, 15. decembris. Ragusii. Bogoe Galvanus marangonus promittit "Dapcho caligario de Antibari" "complere copertam tecti domus lapidee et parimenta duo, videlicet unum in cōdis et alterum in primo solarario". AAlb. II, nr. 272.

¹¹⁷ I. Mahnken, "Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern...", f. 374.

¹¹⁸ Po aty.

¹¹⁹ Po aty.

¹²⁰ "26. noveinbris (1391) "Nicola Lazarovich de Sancto Sergio Odrini" praesente patre suo Lazaro obligat se stare 7 annos apud calegarium Ragusinum, qui „ei instruat artem calligarie" AAlb. II, nr. 434.

¹²¹ I. Mahnken, "Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern...", f. 374.

¹²² AAlb. II, nr. 376.

etnia e Nikollës, por jemi të mendimit se edhe ai mund të ketë qenë shqiptar. Në librat e arkivit të Raguzës përmenden edhe këpucëbërës (*cerdoni*) nga qyteti i Balecit.¹²³ Si të tillë, por njëkohësisht edhe si këpucar in e fundit në këtë artikull po përmendim Dobroslavin nga Baleci (*Dobroslauus de Balezio chalgarius in Ragusio*), i cili përmendet në vitin 1403 dhe që jetonte në atë kohë në Raguzë. Ai kishte marrëveshje të ndryshme pune dhe tregtie me vëllezërit shkodoranë Stefan dhe Jakob Roza, anëtarë të familjes fisnike shkodorane Rosa.¹²⁴

Lëkurëpunuesit

Profesioni i lëkurëpunuesit merrej me regjien e lëkurave të bagëtive. Nëpër dokumente këtë profesion e gjejmë me fjalën *pilliparius*. Nëpër dokumentet raguzane lëkurëpunuesit shqiptarë i gjejmë që në shek. XIV dhe ndër ta po përmendim Gjon Lëkurëpunuesin, i biri i të cilit, *Menge* përmendet në vitin 1353.¹²⁵ Në vitin 1427, përmendet shqiptarja *Petrussa Bosichichi arbanensis*, e motra e Ratcho Bosichichichouich, e cila ishte e martuar me lëkurëpunuesin Bielosau Radoucich pelliparius, për të cilin nuk mund të përcaktojmë, nëse ishte shqiptar apo jo.¹²⁶

Rripaxhinjtë

Me *rripaxhinj* po shënojmë ata zejtarë që merreshin me punimin e rripave. Këtë zanat e gjejmë me fjalën "*magistri centurarium*". Ndër këta përmendet në Raguzë Mense, mjeshtri i rripave nga Durrësi (*Mençe magister centurarurn de Durachio*), i cili jetonte atje në vitin 1333.¹²⁷ Po atë vit ai merr në punë si çirak Andrean të birin e Bonbaratit të ndjerë po nga Durrësi (*Bonbarati de Durazzo*).¹²⁸ Mesa duket Durrësi në Mesjetë, përveçse "eksportonte" mjeshtër që prodhonin rripa, ishte njëkohësisht edhe i njohur për këto lloje produktesh, të cilat dërgoheshin jashtë vendit, sepse pronari i një anijeje që transportonte mallra për në Raguzë, por që sulmohet dhe grabitet në vitin 1335 nga piratët në ujërat Dalmate,

¹²³ K. Jireček, "Skutari und sein Gebiet im Mittelalter...", f. 101.

¹²⁴ AAlb. II, nr. 716.

¹²⁵ I. Mahnken, "Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern...", f. 375.

¹²⁶ Po aty.

¹²⁷ V. Han, "La culture materielle des Balkas...", në: *Balcanica III/1972*, f. 180.

¹²⁸ Po aty, f. 180.

përmend në listën e objekteve të plaçkitura, gjithashtu edhe *rripa prej Durrësi (centuras VI de Duraço valoris yperperi I)*.¹²⁹ Sipas studiueses Verena Han, duke pasur parasysh çmimin tepër modest të këtyre rripave, pra gjashtë copë (*centuras VI*) me një vlerë prej 1 perper (*yperperi I*) mund të supozohet, se ato ishin rripa tekstili ose lëkure, ndoshta të bërë në një mënyrë të veçantë, por gjithsesi jo të një cilësie shumë të lartë.¹³⁰

Rrobaqepësit

Nëpër dokumente përmenden edhe shumë rrobaqepës shqiptarë të cilët ushtronin zanatin e tyre dhe jetonin në Raguzë. Këtë profesion nëpër dokumentet e kohës e gjejmë me termat latine “*çuparius*”, “*zuparius*”, dhe “*sardus*”. Si të parin ndër këta këpucarë mund të përmendim Mikel rrobaqepësin nga Durrësi të dokumentuar që në vitin 1328. Në këtë vit, Mikeli së bashku me gruan e tij, Stanën (*Michael çuparius de Durachio et Stana uxor eius*) i japin si peng Gjergj Shqiptarit shtëpinë e tyre prej druri.¹³¹ Tek vëllimi dokumentar *Acta et diplomata Albaniae* Mikeli nga Durrësi përmendet si mjeshtër rrobaqepës (*Michael de Dyrachio, magister zuparius*).¹³² Edhe rrobaqepësi Rodaslav Liesevich, të cilin e përmend studiuesja gjermane I. Mahnken, duhet të ketë qenë shqiptar, ose me origjinë nga Arbëria.¹³³

Në fillim të shek. XV mund të përmendim edhe rrobaqepësin Doince, i cili përmendet në një dokument testamentar. Doince jetonte në Raguzë dhe i lë kishës së Shën Shirqit në Bunë (*Sancto Sergio del Drino*) për një kelshejt 70 perperë, dhjakut Ivan, të birit të Mencës nga Tivari i lë 100 perperë, të cilat ai do t'i dërgonte tek kisha e Shën Dedës në Ulqin për të blerë një kabanë.¹³⁴ Këtij dhjaku (Ivanit, të birit të Mençës) ai i kishte lënë mesa duket 400 perperë gjithsej, nga të cilat 150 do t'i jepeshin nënës së tij në rast se ai do të vdiste.¹³⁵

Më 21 shkurt 1402 në Raguzë është i dokumentuar edhe një rrobaqepës

¹²⁹ Po aty, f. 179.

¹³⁰ Po aty, f. 180.

¹³¹ I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern...”, f. 374.

¹³² AAlb. I, f.

¹³³ I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern...”, f. 374.

¹³⁴ *Dokumente për historinë e Shqipërisë të Shek. XV. I. (1400-1405)*, përgatitur nga Injac Zamputi dhe Luan Malltezi. Redaktor përgjegjës Aleks Buda. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë: 1987, dok. nr. 371.

¹³⁵ Po aty, dok. nr. 371.

tjetër shqiptar i quajtur Johan Shqiptari (*Johannem Albanensem Sartorum*), i cili ishte hedhur në gjyq nga një hebre i quajtur Isak (*Ixaxh Ebreus*), sepse ishte rrahur prej tij,¹³⁶ ngaqë ky ishte munduar që t'i merrte Johanit nga dora, pa paguar, një xhaketë të cilën ai e kishte përgatitur për ortakun e tij, mjeshttrin rrobaqepës Rikardin.¹³⁷

Përveç rrobaqepësve shqiptarë kemi edhe pëlhura dhe veshje shqiptare të cilat ose vinin nga trojet arbërore ose qepeshin në Raguzë nga mjeshtërit rrobaqepës shqiptarë që jetonin aty. Ndër pëlhura, mund të sjell si shembull këtu *zambelotto* që përmendet në fund të shek. XIV në Raguzë e që ishte një pëlhurë e bërë nga leshi deve dhe sillej nga Vlora¹³⁸, apo edhe pëlhura tjetër shqiptare e përmendur përgjithësisht si “*unam peciam pani albani, 1402*”.¹³⁹

Meqenëse pëlhurat shqiptare përmenden si në posedim të rrobaqepësve të Raguzës mund të supozojmë se banorët nga Raguzë i kishin prerë rrobat tek këta rrobaqepës. Nëpër dokumentet e Raguzës përmenden edhe lloje rrobash që vishnin shqiptarët. Për shembull, në shek. XV përmenden dy lloje xhaketash që përdroreshin në Arbëri, njëra ishte *pavonasa* (*pavonaça*) dhe tjetra, duke u nisur nga emri, mbase ishte nga mëndafshi dhe me ngjyrë të gjelbër (*alia est sete viride*).¹⁴⁰ Pra, këto xhaketa të modës shqiptare që përmenden në Raguzë dhe përdroreshin nga shqiptarët duhet të jenë realizuar pa diskutim nga rrobaqepës që ishin kryesisht me origjinë nga Arbëria.

Berberët

Në Raguzë kemi të dokumentuar edhe berberë shqiptarë. Fjalën berber e gjemë nëpër dokumente me “*barberius*” “*barbier*”. Ndër këta berberë që jetonin dhe ushtronin zanatin e tyre në Raguzë përmenden mjeshtri Pjetër berberi, me të birin Aleksin (*Alexio fante che fo de maestro Piero barbier*) që vdiq në vitin e murtajës 1391. Mesa duket këta e kishin origjinën nga Durrësi, sepse në testamentin e Aleksit përmendet i

¹³⁶ *Po aty*, dok. nr. 191.

¹³⁷ *Po aty*.

¹³⁸ “*unam peciam zambilloti virmilei, laboratum ad Avalonam, 1389*”. V. Han, “La culture materielle des Balkas...”, në: *Balkanica III*, Beograd: 1972, f. 179.

¹³⁹ *Po aty*, f. 179.

¹⁴⁰ “*et duos vestes ad usum Albanie quorum una est pavonaça et alia est sete viride, 1444*”. *Po aty*, f. 179.

vëllai i tij, *Goni* (ose *Gjoni*), i cili jetonte në Durrës (*Gon mio fradello che sta in Duraio*).¹⁴¹ Në vitin 1465, përmendet berberi *Kuksa Bozidaroviç* (*Vuxa Bosidarouich barberius*), i cili në martesën e tij të parë kishte për grua një shqiptare me emrin *Zhivana*, mbesën e një farë *Pjetër Martin* (*Martinoviç*) *Shqitarit* (*Zivana neptis. q. Petar Martinouich albanensis*).¹⁴² Mbi identitetin etnik të *Vuksës* nuk mund të japim një përcaktim të saktë. Ai mund të ketë qenë sllav, por nuk përjashtohet mundësia që të ketë qenë shqiptar.

Pijeshitësit dhe pronarët e tavernave (tavernaxhinjtë)

Në Raguzë kemi të pranishëm edhe pijeshitësit nga trojet arbërore. Këtë profesion e gjejmë me termin "*tabernarius*". Ndër këta pijeshitës përmendet në vitin 1383 *Pervoshi* nga *Shasi* (*Peruossius de Suacio tabernarius*).¹⁴³ Më tej, rreth gjysmës së dytë të shek. XV përmendet edhe *Dobrica*, një grua nga *Spici* i *Arbërisë*, e bija e *Bogdan Dobrecinoviçit* (*Dobrica f. Bogdani Dobrecinouich de Spiç de Albania*), e cila ishte e martuar me tavernaxhiun *Pribisav Radosagliqin* apo të quajtur ndryshe *Kraglin* (*Pribissauus Radosaglich dictus Chragl*)¹⁴⁴.

Mësuesit e shkollave

Në një akt raguzan të vitit 1345 përmendet një klerik shqiptar i quajtur *dom Nikolla* që ishte mësues në një shkollë (*dompno Nicole arbanensi magistro scolarum*).¹⁴⁵ Një vit më vonë, më 11 tetor 1346 përmendet në *Stanjo* një *Nikollë shqiptari* (*domnus Nicola arbanensis*), i cili përzgjidhet si prift në kishën e *Manastirit* të atij vendi.¹⁴⁶ Nëse këtu kemi të bëjmë me të njëjtin person apo jo, dokumentet që kemi në dispozicion nuk e bëjnë këtë të qartë. Por, nuk përjashtohet mundësia që këto dy dokumente të viteve 1345-46 të kenë të bëjnë me të njëjtin *dom Nikollë Shqiptari*.

¹⁴¹ I. Mahnken, "Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern...", f. 375.

¹⁴² Po aty.

¹⁴³ Po aty.

¹⁴⁴ Po aty.

¹⁴⁵ "*dompno Nicole arbanensi magistro scolarum*". AAlb II, nr. 55, ref. 2.

¹⁴⁶ "*domnus Nicola arbanensis electus fuit presbiter monasterii ecclesie Stagni*". Liber Reformationum I, (1306-1347), f. 245.

Një drishtënj në vitin 1388 kishte hapur një shkollë fillore në Stagno të Raguzës. Ky ishte Teodori, i biri i zotit Nikollë nga Drishti dhe për këtë shkollë merret vendimi që t'i jepeshin Teodorit 10 perperë, si ndihmë financiare për pagesën e qirasë së shtëpisë, ku ishte vendosur kjo shkollë.¹⁴⁷ Aty ai do t'i jepte mësim në gramatikë të gjithë atyre që do të donin.¹⁴⁸ Më vonë në dokumente del se ai ishte i martuar dhe e shoqja e tij quhej *Stancha*, e cila lë një testament në vitin 1401.¹⁴⁹ Ka shumë mundësi që Teodori, i cili nëpër dokumente na paraqitet si prift (*presbiter*), më vonë të jetë martuar, ose mund të ketë qenë edhe prift ortodoks, *gjë që duket shumë e pamundshme*, ngaqë vendi i tij i origjinës, Drishti ishte qendër e rëndësishme e Kishës Katolike në Arbëri dhe konsiderohej dhe si fidanishte e klerit katolik shqiptar. Plus kësaj nuk na rezulton të ketë pasur kishë ortodokse në truallin e vet.

Muzikantë

Muzikantët i gjejmë kryesisht me termat *tibicinis* (fyelltar), *piffarus* (flautist, fyelltar), *tubator* (borizan), etj. Si të parin mund të përmendim këtu Kolë Durrsakun (Colla de Durachio), i cili mesa duket ka qenë aktiv gjatë viteve 1390-1404. Në një dokument të vitit 1389, në Këshillin e Vogël të qytetit merret vendimi që Kola të pajtohet me një rrogë prej 100 perperë për gjithë vitin 1390, të paguar nga vetë komuna e Raguzës.¹⁵⁰ Nëpër dokumente përmenden më 9 maj 1399 edhe Tomazina, e bija e Kolës, e cila u martua me rrobaqepësin Bocco, të birin e Johannes de

¹⁴⁷ "1388. 19. Decembris. Ragusii. Drivastensis Stagno scolam aperit. In eodem consilio (minore) catum fuit, quod dentur yperperi X Theodore filio d(omi)ni Nicole de Drivasto pro afflictu domus, in qua debet tenere scolares in Stagno pro docendo eos legere et scribere". AAlb. II, nr. 435. Krahaso edhe: Milan von Šufflay, *Städte und Burgen Albaniens hauptsächlich während des Mittelalters*. Vorgelegt in der Sitzung am 24. April 1918. Kommissions-Verleger der Akademie der Wissenschaften in Wien. Wien/Leipzig: Hölder-Pichler-Tempsky A.-G. 1924, f. 45.

¹⁴⁸ "ubi doceat quoscumque violentes discere gramaticam". I. Mahnken, "Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern...", f. 371.

¹⁴⁹ Po aty.

¹⁵⁰ *Državni Arhiv u Dubrovniku* (DAD), Reformationes XXVIII, fol. 38 v: "In dicto Minori consilio cantum fuit de recipiendo ad samarium Communis Collam trembetam pro uno anno proximo cum salario yperperm centum quantum habet Colla trobeta. Qui teneatur et debat pulsare temporibus debitis secundum quod teneatur alli pulsatores et modis consuetis", tek: Jahja Drançolli, *Arbërit ndërmyet Perëndimit dhe Lindjes gjatë Mesjetës*. Zagreb: Misioni Katolik Shqiptar Kroaci, 2008, f. 420.

Brundisio në Raguzë,¹⁵¹ kurse në një dokument tjetër të datës 8 shtator 1404 përmendet edhe një shërbëtorë Stanula, e cila i largohet nga shtëpia.¹⁵²

Ndër muzikantët mund të përmendim Filipin e Drishtit (*Filipus de Drivasto*, i quajtur ndryshe edhe *Filipo Fiorentino*), muzikant (borizan), por që merrej edhe me zejen e prodhimit të thikave dhe të flamujve.¹⁵³ Ai duhet të ketë qenë aktiv në Raguzë sidomos gjatë viteve 1441-1461, sepse gjatë kësaj periudhe emri i tij haset dendur nëpër dokumente. Sipas J. Drançollit përmendet rreth 50 herë dhe përveç emrave *Filipus de Drivasto*, edhe *Filipo Fiorentino*, haset edhe me llogarët *de Feraria*, *de Cinganus*, *de Angiari*.¹⁵⁴ Ai mbahet edhe si krijuesi i një stili të ri në muzikë (apo i një instrumenti të ri) të quajtur “*kënga, apo melodia e ëmbël*” (*dulce melos*) dhe në vitin 1448 nga komuna e Raguzës i rritet rroga nga 180 në 200 perperë në vit.¹⁵⁵

Përveç muzikantëve shqiptarë në Raguzë kemi të pranishëm edhe muzikantë raguzanë në Arbëri. Për ta plotësuar kuadrin, po përmendim shkurt vetëm një rast. Kështu, më 3 shtator 1395 i jepet leja flautistit (*piffaris*) të Raguzës që të shkojë e të marrë pjesë në festën e Shën Marisë së Rotecit në Arbëri, duke i dhënë këtij edhe një pagesë të caktuar.¹⁵⁶ Emri i flautistit nuk shënohet në dokument.

* * *

Këto pra, ishin disa të dhëna në lidhje me zejtarët dhe zanatçinjtë e ndryshëm që jetonin dhe punonin në Republikën e Raguzës në Mesjetë, sidomos gjatë shek. XIV-XV.

¹⁵¹ J. Drançolli, *Arbërit ndërmjet Perëndimit dhe Lindjes...*, f. 420.

¹⁵² *Po aty*.

¹⁵³ Miho Demović, *Musik und Musiker in der Republik Dubrovnik (Ragusa) vom Anfang des XI. Jahrhunderts bis zur Mitte des XVII. Jahrhunderts*, Regensburg: Bosse 1981, f. 140.

¹⁵⁴ J. Drançolli, *Arbërit ndërmjet Perëndimit dhe Lindjes...*, f. 421.

¹⁵⁵ *Po aty*.

¹⁵⁶ “*In minori consilio ad sonum campane more solito congregato facta fuit gracia piffaris nostris Ragusii salariatis eundi ad festum s. Marie Reteçii durando salarium.*” AAlb. II, nr. 538.

*S u m m a r y*ALBANIAN MASTERS AND CRAFTSMEN IN RAGUSA
DURING THE MIDDLE-AGES

This article makes an overview of the Albanian masters and craftsmen who exercised their activity in Ragusa especially during the 14th and 15th centuries. They mastered different professions and were: architects, sculptors, stone carvers, blacksmiths, smiths, gun makers, sailors, rowers, carpenters, goldsmiths, shoemakers, tanners, belt makers, tailors, barbers, liquor sellers, bar owners and school teachers.

Thus, the specter of professions dealt with in this article is quite wide. The information and data in this study were obtained from various researches and a large number of published archival documents. Moreover, this is one of the few studies which focuses thoroughly on the Albanian craftsmen of Ragusa.

